



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

08-12-2023

Prishtinë / Priština

011263-2023



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5 paragrafi 1.3, dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 08.12.2023, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Z.Basri Menxhiqi**, emërohet anëtar i Kuvendit Komunal në Vushtrri, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal z.Ilmi Azemi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Basri Menxhiqi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 06.12.2023, Nr.09/1/1248/2023, për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal z.Ilmi Azemi, i cili ka dhënë deklaratën e dorëheqjes, për arsye personale.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati në listën e rënditur është z.Basri Menxhiqi.

Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 08.12.2023

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radonjqi

